

SHIFRA E NXËNËSIT

PROVIMI I MATURËS

JANAR 2020

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike.

Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Testi DUHET të shkruhet LEXUESHËM me laps kimik. Nxënësi/nxënësja mund të shkruaj me shkronja dore ose shtypi. Nëse shkruan me shkronja shtypi DUHET të theksojë shkronjën e madhe.

Testi përmban detyra të cilat zgjidhen në njëren prej mënyrave në vazhdim:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë. Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes të përshkruash përgjigjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:

- është e pasaktë
- përgjigjja në detyrë me zgjedhje të shumëfishtë NUK është bart në fletën e përgjigjeve
- është rrethuar ose shkruar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë
- përgjigjja/eseja është e palexueshme dhe e paqartë
- përgjigjja/eseja është shkruar me laps të thjeshtë
- eseja NUK është shkruar në vendin e paraparë, por vetëm në faqet e parapara për koncept (shkrimi i konceptit nuk është i detyrueshëm)

Nëse gabon, vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh punën, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tua.

Me fat!



* A 1 0 0 1 0 0 8 *

FAQE E ZBRAZËT

Teksti 1

SHPK "MONIKA" Fabrika e produkteve farmaceutike dhe kimike, 81000 Podgoricë, rruga Jollo Piletiq, numër 292, Telefoni: 020/111-111, Fax:020/222 222, www.monotrgovina.com, mono@me, xhirollogaria: 1111 – 111 – 11 – 111

Shenja juaj: SV-1

Shenja jonë: MB/RP-2

Podgoricë, 12.03.2009

FARMACIA E VETERINARISË
"BOTA SHTAZORE"

-Drejtorit S. Pepiq

N. Merdoviq nr. 145

84 000 Bijello Pole

Lënda: Oferta

I nderuari zotëri Pepiq,

Në bazë të kërkesës Tuaj për katalog të produkteve tona nga data 28.02. e vitit në vazhdim, Ju ofrojmë dërgimin e mallit në gjithçka sipas kushteve të kësaj oferte:

- sh. 563 – ENBECIN, aeroposim, 200 g, (0,825 mg + 62, 5 dhe nj./1 g) – 4,50 € / copa;
- sh. 644 – FLUMIVET, plv.100 g dhe 1 kg (0,1 g/1 g) – 23,00 €/kg;
- sh. 122 – OKSITETRACIKLIN VP, plv. 20 g (55 mg / 1 g) – 8,50 € /copa
- sh.. 444 – RESOGAL, balsam 100 g - 0,69 € / copa;
- sh. 865 – VITOGAL, plv.20 g dhe 1 kg – 87,60 € / kg.

Çmimet janë të shitjes me shumicë, pa llogaritjen e TVSH-së. Kushtet e shitjes dhe çmimet janë të vlefshme deri më 1 qershor 2009. Afati i pagesës është 10 ditë nga marrja e mallit.

Vendi i dërgesës është franko magazina Juaj tri ditë pas bërjes së porosisë. Paketimi dhe ambalazhi janë të fabrikës.

Marrja sasiore dhe cilësore do të jetë në pikën e dërgesës.

Me shpresë se programi ynë i prodhimit dhe kushtet e shitjes do T'ju përgjigjen, Ju përshëndesim përzemërsisht.

Drejtoresha

Monika Bullatoviq

V.V.

(mr. ph. Monika Bullatoviq)

Teksti 2

FARMACIA E VETERINARISË "BOTA SHTAZORE" 84 000 Bijello Pole, N. Merdoviq nr. 145, Telefoni: 050/333-333, Fax: 050/ 444 444, xhirollogaria: 2222 – 222 – 22 – 222
www.animalpharma.com, pharmacybp@me

Shenja juaj: MB/RP - 2
Shenja jonë: SV - 2

Bijello Pole, 17.03.2009

"MONIKA"
- Drejtoreshës" -

Rruga Jollo Piletiq, 292
81000 Podgoricë

Lënda: Porosia numër 453/09

E nderuara zonja Bullatoviq,

Lidhur me ofertën Tuaj për ofertën MB-RP2, të datës 12.03.2009,
Ju lutem që pas marrjes së kësaj porosie të dërgoni mallin si në vazhdim:

| SHIFRA | EMËRTIMI | NJËSIA MATËSE | SASIA |
|--------|--------------------------------|---------------|-------|
| 644 | FLUMIVET, plv.1 kg | kg | 19 |
| 122 | OKSITETRACIKLIN VP, PLV. 20 g. | copë | 290 |
| 444 | RESOGAL, balsam 100 g | copë | 150 |

Pagesa do të bëhet menjëherë me marrjen e llogarisë Tuaj,
ndërkohë që i pranojmë të gjitha kushtet nga oferta.
Bashkëngjitur Ju dorëzojmë deklaratën e përgjithshme të vërtetu-
ar.

Me respekt.

Sh t o j c a: 1 (një)

ME TELEFAKS

V.V.

Drejtori

Safet Pepiq

(mr. ph. Safet Pepiq)

¹ Vesna Bullatoviq: *Komunikimi afarist dhe biroteknika*, Qendra për Arsimim Profesional, Podgoricë, 2011

1. Me cilin stil funksional janë shkruar tekstet?

1. administrativ
2. letraro-artistik
3. publicistik
4. bisedimor

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

2. A) Kujt i kushtohet teksti i dytë nga dy tekstet e dhëna?

1 pikë

B) Cili është qëllimi i tekstit të dytë?

1 pikë

3. Nga cili vend është nisur teksti i parë?

1 pikë

4. Shkruaje emrin e plotë të firmës që bëri kërkesën për katalogun e produkteve farmaceutike.

1 pikë

- 5.** Nëse konstatimi është i saktë rretho S, ndërsa nëse është i pasaktë rretho P dhe shpjegoje përgjigjen.

| KONSTATIMI | SAKTË PASAKTË | SHPJEGIMI I PËRGJIGJES |
|--|----------------------|------------------------|
| Kërkesa për nisjen e katalogut të produkteve farmaceutike është dërguar më 12. 03. 2009. | S P | |

1 pikë

Duke shfrytëzuar tekstin zhvillo detyrat 6, 7, 8 dhe 9.

Parashikimi i motit, përkatësisht rrethanave meteorologjike, është një proces shumë kompleks i cili përfshin zbatimin e metodave matematikore, të bazuara në modelimin numerik të proceseve meteorologjike dhe interpretimin e rezultateve të modeluara. Në një përlogaritje të tillë aplikohen kompjuterët më të mirë (tashti janë kompjuterët me procesorë paralel dhe të ashtuquajturit super kompjuterët) për shkak të një numri të madh të parametrave dhe operacioneve llogaritëse që modeli i tillë duhet të përfshijë. Modeli cilësor meteorologjik integron madje edhe elementet hidrologjike (me të dhënat për gjendjen e sipërfaqeve statike dhe dinamike të ujërave), si dhe gjendjen e ndotjes atmosferike në rajon. Parashikimi më cilësor i motit arrihet duke vëzhguar fenomenet dhe proceset meteorologjike me ndihmë të satelitëve të posaçëm meteorologjikë gjeostacionarë dhe polarë, të pajisur me pajisje speciale për monitorim dhe regjistrim të shumë parametrave fizikë në atmosferë.

- 6.** Nëse pohimi është i saktë rretho PO, kurse nëse nuk është i saktë rretho JO.

| | | |
|---|----|----|
| Parashikimi cilësor i motit arrihet me aplikimin e modelimit astrologjik të proceseve meteorologjike. | PO | JO |
| Për parashikimin cilësor të motit janë të rëndësishëm kompjuterët me procesorë paralel. | PO | JO |
| Vëzhgimi i fenomeneve meteorologjike me ndihmë të satelitëve të gjeostacionuar i kontribuon parashikimit më cilësor të kohës. | PO | JO |

1 pikë

7. Cila lëndë mësimore është e rëndësishme për modelimin e proceseve meteorologjike dhe interpretimin e rezultateve të modeluara?

1 pikë

8. Rretho numrin para grupit të fjalëve që ka të bëjë me stilin shkencor dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. kompjuterët më të mirë
2. parashikimi i motit
3. modelimi i proceseve meteorologjike

1 pikë

9. Çfarë të dhënash mësojmë, përveç parashikimit të motit, në bazë të një modeli cilësor meteorologjik?

1 pikë

10. A) Rretho numrin para personazhit i cili nuk i përket grupit.

1. Gjini
2. Zeneli
3. Vangjeli
4. Marigona

1 pikë

B) Argumento përgjigjen.

1 pikë

Në bazë të fragmentit të dhënë, si dhe veprës në tërësi, zhvillo detyrat 11 dhe 12.

E drejta dokesore e maleve shqiptare, e njohun në përgjithësi me emnin *Kanun*, ka qenë trashigë brez pas brezi, tue zevendesue ligjin në trevat malore në votra qindrese vetëmbrojtëse në Shqipëri.

Për mbledhjen e lëndës së *Kanunit të Maleve*, në trevën e Mirëditës Gjeçovi ka punue kryesisht ku ishte famullitar në famullinë e Gomsiqes, gjatë periudhës 1907 – 1915.

Përmbledhja e parë ose si mund ta quajmë edhe versionin e parë të Kanunit asht ajo e At Shtjefën Gjeçovit, e mbledhur gati krejt në Mirëditë dhe e publikueme pjesë pjesë tue fillue prej vjetit 1913 në revistën “Hylli i dritës” dhe si botim i plotë, mbas vdekjes së autorit më 1933 nën titullin “Kanuni i Lekë Dukagjinit”.

Kjo përmbledhje ka tërhequn vëmendjen e studiuesve të vendeve të ndryshme, asht përkthye në shumë gjuhë, asht ribotua disa herë e vijon të ribotohet.

Mbledhja e materialeve të Kanunit për Gjeçovin ka qenë një punë mjaft e vështirë për shkak të këtyre rrethanave.

- Gjeçovi ka le dhe asht rritun jashtë trevës ku zbatohet Kanuni.
- Gjeçovi ishte formue si klerik, si françeskan e jo njohës i kulturës shpirtërore.

(Pal Doçi “Për Kanunin”, 2003)

11. A) Çfarë kuptojmë me termin *Kanun*?

1 pikë

B) Cilës fushë, si lëndë studimi dhe kërkimi, i takon më së shumti kjo vepër?

1 pikë

12. A) Çfarë shpreh autori i këtij shkrimi me paragrafin e fundit?

1 pikë

B) Në cilin dialekt është shkruar ky shkrim?

1 pikë

13. Pranë emrit të personazhit letrar shkruaje titullin e veprës letrare në të cilën paraqitet dhe emrin dhe mbiemrin e autorit të saj.

(vepra)

(emri dhe mbiemri i autorit)

Janathas _____

Zonja Kapulet _____

Vurkua _____

3 pikë

14. Me cilën formë të shprehjes artistike është shkruar fragmenti?

| PERSONAZHI | VEPRA | VEPRIMI I PERSONAZHIT |
|------------|------------------------------|---|
| | <i>Nga jeta në jetë-pse?</i> | Shpreh mospajtimin me gjendjen shoqërore të sistemit shoqëror të asaj kohe. |
| | <i>Kurora e maleve</i> | Madhësia, guximi i madh i një gruaje që ndihmon burrin e saj në luftë. |

2 pikë

15. Ka njerëz që vuajnë për kafshatën e gojës.

Fjala e nënvizuar në fjalinë që posa lexove është:

1. kundrinë e zhdrejtë pa parafjalë
2. kundrinë e drejtë
3. kundrinë e zhdrejtë me parafjalë

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

16. Fjalinë *Abdyl Frashëri ka thënë që të bashkohen me një besë të gjithë shqiptarët, kaloje në ligjëratë të drejtë.*

1 pikë

17. A) Pranë titullit të veprës shkruaj gjininë letrare të cilës i përket vepra.

1. *Qiriri* _____
2. *Syrgjyn vdekur* _____
3. *Don Kishoti* _____
4. *Hamleti* _____

1 pikë

B) Cila vepër nga detyra nën A është roman?

1 pikë

Lexo vargjet nga *Këngët e Milosaos - Kënga XXX* e De Radës dhe përgjigju në pyetjet 18, 19 dhe 20.

Frye era e maleve
dhe rrëzoi hijen e lisit.
Gjaku im te lumi i Vodhi.
Hapeni shtatoren,
o ushtarë, që të shoh
Shkodrën edhe time motër
te dritarja kundruall.
Atje nuk do zgjohem më
luleve që i tund era
si suvalë e pasosur.
Mblidhen shokët mbrëmanet
në katund, në vatërët.
Unë i lash si ëndërrëz.

18. A) Si quhen vargjet që përdor poeti në këtë poezi?

1 pikë

B) Çfarë i karakterizon këto vargje?

1 pikë

19. Në vargun e tretë të kësaj kënge mungon një nga gjymtyrët kryesore të fjalisë. Cila është ajo? Rishkruaje vargun duke e shtuar këtë gjymtyrë të nënkuptuar.

2 pikë

20. Cila ishte kërkesa e fundit e Milosaos dhe çfarë nënkupton kjo për të?

2 pikë

21. Në cilën kohë është folja SHKRUANIM?

1 pikë

22. Shkruaji në tabelë veprat e dhëna, duke përcaktuar gjininë letrare të tyre dhe epokën të cilës përkasin (ashtu siç është filluar). Kij kujdes dy epoka letrare në tabelë janë të tepërta.

- a) *Antigona*
- b) ~~*Kanconieri*~~
- c) *Xha Gorio*
- d) *Albatrosi*

| | GJINIA LETRARE | | |
|---------------|-------------------|--------------------|-------|
| | Lirika | Epika (Narracioni) | Drama |
| EPOKA LETRARE | | | |
| Antike | | | |
| Renesanca | <i>Kanconieri</i> | | |
| Baroku | | | |
| Romantizmi | | | |
| Realizmi | | | |
| Moderne | | | |
| Avangarde | | | |

1 pikë

23. Në veprën *Gilgameshi*, kur mbreti Gilgamesh, ulet dhe shkruan në pllakë të gurit kërkesën që u drejtohet të gjithëve, për ta lexuar atë që do të shkruaj ai:

*“Merr këtë lapis lazuli dhe lexoi
Udhëtimet e Gilgameshit, krejt kah ka shkruar rrotull”*

Në cilën vetë të narratorit shfaqet Gilgameshi në vargje e veçuar?

1 pikë

24. A) Rretho numrin para fjalës së shkruar saktë:

1. çbllokoj
2. xhbllokoj
3. zhbllokoj

1 pikë

B) Argumentoje përgjigjen duke treguar përse duhet të jetë e saktë zgjedhja jote.

1 pikë

25. A) Vendosi presjet atje ku e përcakton norma drejtshkrimore.

“Mali i Korabit që ngrihet mbi 2000 metra është maja më e lartë e Shqipërisë.”

1 pikë

B) Në fjalinë e dhënë presjet tregojnë se kjo fjali është një fjali e përbërë me:

1. nënrenditje përcaktuese
2. bashkërenditje veçuese
3. bashkërenditje shtuese

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

26. A) Fjalët nga kllapat shkruaji në rasën e duhur.

Nuk di të përdor _____
(telefoni i ri mobil)

1 pikë

B) Shkruaj me shkronja numrat:

117 _____

44 _____

1 pikë

Lexo fragmentin nga *Hamleti* i U. Shekspirit dhe pastaj përgjigju në pyetjet 27, 28 dhe 29.

*„A është më bukur të vuash në zemër
Llastiqet dhe shigjetat fatet e **hidhura**,
Ose edhe në armë kundër detit të mjerimit
Të ngrihesh, dhe me luftë t’ua japësh fundin?
Të vdesësh – të flesh – asgjë më shumë –
Thuaj që gjumi i jep fund dhimbjes
Dhe mijëra tronditje të jetës.“*

27. Si quhet figura stilistike e theksuar dhe nënvizuar në vargun e dytë?

1 pikë

28. Gjendja e kujt psikologjike është paraqitur në vargje?

1. Hamletit
2. Klaudios
3. Ofelisë

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

29. Cila veti e personazhit vjen në shprehje?

1. siguria
2. pavendosmëria
3. hakmarrja

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

30.

Janë ofruar dy tema për hartimin e esesë. Rrethoje numrin para temës që do ta zhvillosh. Eseja duhet të përmbajë 250 deri në 300 fjalë.

Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin. Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHEM FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi).

Kij kujdes për saktësinë gjuhësore dhe që teksti të jetë i lexueshëm.

1. Vlladikë Danilloja – ndërmjet sundimtarit dhe njeriut

Udhëzime për shkrimin e esesë:

- Përshkruaje botën e “Kurorës së maleve”.
- Veço heronjtë dominues (të paktën 3 heronjë duke përjashtuar vlladikën Danillo, shkurtimisht përshkruaje karakterin e tyre dhe trego për rolin e tyre në vepër.
- Shpjego çfarë e veçon vlladikën Danillo nga heronjtë tjerë.
- Përshkruaje vlladikën si sundimtar dhe njeri:
 - çfarë e bën pozitën e sundimtarit të vështirë dhe dramatike (argumento me shembuj, vargje etj.)
- Igumen Stefani i thotë vlladikës: *“Ti je i ri vlladikë, madje edhe i papërvojë!”*. Shpjego në çfarë është i papërvojë vlladika.
- Në formë të përfundimit shpjego nëse vlladika pajtohet me situatën.

2. (Pa) Kultura ekologjike

Udhëzime për shkrimin e esesë:

- Trego çfarë është sot gjendja në lëmin e mbrojtjes së mjedisit jetësor në botë sipas njohurive tua.
- Shpjego në çfarë mënyre njeriu e rrezikon mjedisin e vet jetësor.
- Shpjego si është raporti i banorëve ndaj mjedisit jetësor në vendin tënd.
- Ceki shembuj pozitiv të përparimit në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor në vendin ku jeton ti, rrethin ose botën të cilët do të mund të na shërbenin si shembuj që ta ruajmë biodiversitetin dhe jetën e shëndetshme në vendin tonë.
- Me cilat probleme të mbrojtjes së mjedisit jetësor edhe më tej ballafaqohet popullata e vendit tënd/zonës tënde. Jepi shkaqet e dukurive të tilla dhe mënyrat që të zgjidhen problemet.
- Jefe mendimin argumentues nëse qytetari i vendit tonë ka kulturë ekologjike?

25 pikë



2

3.

4.

5.

6.

7.

8.

9.

10.

11.

3.

4.

5.

6.

7.

8.

9.

10.

11.